

## KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH KAPITALI

Sot, me datë 11.10.2023 lidhet kjo Kontratë Shitblerje Kuotash Kapitali me kushtet e mëposhtme:

### SHITËSIT:

**Llambi Miti**, i biri i Kozma dhe Vangjello, shtetas Shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga "Medar Shtylla", Pall.43/3, lindur më 07.02.1959, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me ID nr.032509208 dhe nr.personal F90207129J, zotërues i 50% të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë "Tirana Taxi" shpk;

**Tomas Miti**, i biri i Llambi dhe Elida, shtetas Shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga "Medar Shtylla"; Pall.43/3, lindur më 06.07.1994, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me ID nr.037935069 dhe nr.personal J40706075P, zotërues i 50% të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë "Tirana Taxi" shpk;

*(këtu e më poshtë në kontratë do të quhen **Shitësit**).*

### BLERËS:

**Blerim Allani**, i biri i Hamit, dhe Hava, shtetas Shqiptar, lindur në Gizavesh, Librazhd, dhe banues në TIRANË, me adresë Rruga e Bogdaneve; Nd. 1; H. 5; Ap. 25; Njësia Administrative Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 01.04.1983, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me Numër pasaporte BI3960681 dhe nr. personal I30401095Q.

*(këtu e më poshtë në kontratë do të quhet **Blerësi**).*

### OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate është shitja e 50% të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë, me një vlerë nominale prej 1.500.000 (njëmilion e pesëqindmijë) Lekë, të cilat përfaqësojnë

- 25% të kuotave të Kapitalit të Shoqërisë, zotëruar nga ortaku Llambi Miti
- 25% të kuotave të Kapitalit të Shoqërisë, zotëruar nga ortaku Tomas Miti

Dhe shtimi i një ortaku të ri. Secili nga ortakët themelues shet te ortaku i ri gjysmën e kuotës së vet, nga 25% të kapitalit të shoqërisë, në vlerë 750.000 (shtatëqind e pesëdhjetëmijë) secila. Këto pjesë transferohen nga shitësit (ortakët themelues) në pronësi të blerësit për 50 % të kapitalit, vlerë totale 1.500.000 lek.

### BAZA LIGJORE

- Neni 761 e vijues i Kodit Civil
- Neni 73, pika 1, gërma "b" "Për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar" të Ligjit nr.9901, datë 14.08.2009 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

### PËRMBAJTJA E KONTRATËS

Shoqëria "Tirana Taxi" shpk është person juridik i së drejtës shiptare, regjistruar në regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Bizneseve me datë 06.10.2023, me adresë të selisë së saj: *Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga "Tish Dajja", Kompleksi "Kika", Godina Nr.9..*

Shitësi, Z. Llambi Miti, shet gjysmën e kuotës së tij, kundrejt vlerës 750.000 (shtatëqind e pesëdhjetëmijë)lekë, tek Z. Blerim Allani, ose 25% të kapitalit që zotëron në këtë shoqëri që është në vlerë gjithsej 750.000 (shtatëqind e pesëdhjetëmijë) lekë.

Shitësi, Z. Tomas Miti, shet gjysmën e kuotës së tij, kundrejt vlerës 750.000 (shtatëqind e pesëdhjetëmijë)lekë, tek Z. Blerim Allani, ose 25% të kapitalit që zotëron në këtë shoqëri që është në vlerë gjithsej 750.000 (shtatëqind e pesëdhjetëmijë) lekë.

Blerësi, Z.Blerim Allani, pranon pronësinë mbi 50% pjesë të kapitalit të Shoqërisë, të cilat përfaqësojnë 50% të Kapitalit të Shoqërisë .

Pas këtij akti shitblerjeje gjendja e kuotave në shoqëri është;

**1.Llambi Miti** zotëron 1 (një) kuotë me vlerë kapitali **750.000 lekë**, që pasqyron 25% të kapitalit të shoqërisë.

**2.Tomas Miti** zotëron 1 (një) kuotë me vlerë kapitali **750.000 lekë**, që pasqyron 25% të kapitalit të shoqërisë.

**3.Blerim Allani** zotëron 1 (një) kuotë me vlerë kapitali **1.500.000 lekë**, që pasqyron 50% të kapitalit të shoqërisë.

### MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, si dhe me regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, Shitësit, Llambi Miti dhe Tomas Miti, ortakët themelues të shoqërisë "Tirana Taxi" shpk, humbasin nga 25% të kuotave që zotërohen prej tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë "Tirana Taxi" shpk, duke mbetur zotërues secili të 25% të kuotave të kapitalit themeltar, 50% në total, ndërsa Blerësi Blerim Allani, fiton pronësinë e 50% të kuotave të shoqërisë "Tirana Taxi" shpk, duke u bërë zotërues i 50% të kuotave të kapitali themeltar.

### DISPOZITA TË FUNDIT

Blerësi pranon dhe garanton shitësin se njohin të gjitha të drejtat dhe detyrimet mbi kuotat, dhe bëhen pronarë sipas gjendjes në të cilën ndodhen kuotat në momentin e këtij akti shitblerjeje.

Kjo kontratë është hartuar në bazë të dispozitave të Kodit Civil dhe për çfarë nuk është parashikuar në këtë kontratë do të zbatohen dispozitat e këtij Kodi.

Pjesë e kësaj kontrate janë: Vendimi i Asamblesë së Ortakëve datës 11.10.2023 dhe esktrakti Historik i Shoqërisë Tregtare "Tirana Taxi" shpk.  
Kontrata hartohet në katër kopje të njëjta në gjuhën shqipe, nga të cilat një e mbajnë palët, një depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

### **PALËT KONTRAKTUESE**

**SHITËSIT**

**Llambi MITI**



**Tomas MITI**



**BLERËSI**

**Blerim ALLANI**

